



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS

**NJOFTIM PËR SHTYP**

Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e tij më datë 21.10.2022, mori në shqyrtim dy njoftime përqendrimi të realizuar në tregun ndërkombëtar.

1. Përqendrimi i realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Saudi Aramco Development Co Ltd dhe Honeywell Automation and Control Products Ltd;
2. Përqendrimi i realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë VGP Holdings LLC nga shoqëria Aramco Overseas Company B.V., nëpërmjet shoqërisë Gateway Velocity Holding Corp.

Përqendrimet e njoftuara nuk krijojnë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, nuk do të sjellin asnjë ndryshim dhe nuk do të kenë ndikim në tregun shqiptar.

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 914, datë 21.10.2022, vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Saudi Aramco Development Company dhe shoqëria Honeywell Automation and Control Products Ltd; dhe me Vendimin nr. 915, datë 21.10.2022, vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë VGP Holdings LLC nga shoqëria Aramco Overseas Company B.V., nëpërmjet shoqërisë Gateway Velocity Holding Corp.

Gjithashtu në mbledhjen e tij, Komisioni i Konkurrencës, vendosi për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore dhe dhënien e disa rekomandimeve.

Në përfundim të procedurave hetimore, u konstatua se në tregun e paisjeve mjekësore nuk u evidentuan shenja të një sjellje të mundshme antikonkurrese nga ndërmarrjet, për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 916, datë 21.10.2021, vendosi:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e barnave dhe paisjeve mjekësore.
- II. T'i rekomandojë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:
  - a. të propozojë ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 143, datë 18.2.2015 "Për përcaktimin e marzheve të tregtimit dhe fabrikimit të barnave", pika 1,2 dhe 3, duke përcaktuar marzhe maksimale të tregtimit të barnave,
  - b. ngritjen e një sistemi elektronik të regjistrimit të barnave, apo aplikimi i "bar code" në regjistrimin fillestar të barit në territorin e Republikës së Shqipërisë, mekanizma që do

- të bëjnë të mundur që ndërmarrjet të konkurrojnë, nëpërmjet çmimit, në të gjitha nivelet e tregtimit,
- c. të përcaktohen mekanizma kontrollues për regjistrimin, emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullës së kontrollit të barnave nga momenti i regjistrimit në doganë deri tek pacienti final.

Për më tepër, ju lutem konsultohuni me faqen zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës në <http://caa.gov.al/>.